1.8.1 Karakteristikat natyrore

Burimi natyror i ujit në Vërmicë ndodhet në territorin e fshatit Vërmicë, Komuna e Prizrenit, në shpatin verior të masivit malor të Koritnikut, në anën e majtë të luginës së lumit Drini i Bardhë, në një lartësi mbidetare prej 321 m. Ai formohet nga dalja natyrore e ujërave nëntokësore në kontaktin ndërmjet shkëmbinjve gëlqerorë të Koritnikut dhe sedimenteve të Rrafshit të Prizrenit.
Masivi gëlqeror i Koritnikut, i pasur me çarje, zgavra dhe kanale karstike, mundëson infiltrimin dhe akumulimin e ujërave nga reshjet atmosferike, të cilat filtrohen natyrshëm nëpër shkëmbinj dhe dalin në sipërfaqe në formën e këtij burimi. Zona e furnizimit të burimit vlerësohet të jetë rreth

27.63 km², ndërsa prurja e ujit është e konsiderueshme, duke kaluar 250 L/s, çka e rendit atë ndër burimet më të rëndësishme ujore të rajonit.
Matjet e kryera tregojnë se uji ka një temperaturë mesatare prej 9.4°C, pH 7.45, që tregon karakter neutral, dhe përçueshmëri elektrike prej 379 µS/cm, parametra që dëshmojnë për cilësi të mirë fiziko-kimike të ujit dhe stabilitet të tij.
Burimi ka rëndësi të madhe ekologjike dhe socio-ekonomike. Uji i tij përdoret për furnizim me ujë të pijshëm, përgatitjen e ushqimit, ujitje, nevoja blegtorale, peshkim dhe përdorime të tjera. Njëkohësisht, rrjedha e tij kontribuon në furnizimin me ujë të lumit Drini i Bardhë. Mjedisi përreth krijon kushte të favorshme për zhvillimin e bimësisë higrofile dhe organizmave të ndryshëm ujorë, duke pasuruar biodiversitetin lokal.

Gjendja natyrore e burimi të ujit është relativisht e mirë.

1.8.2. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore

Burimi natyral i ujit në fshatin Vërmicë karakterizohet me prurje të konsiderueshme të ujit. Burimi është natyral pa erë dhe përbërje natyrale.

Duke marrë për bazë këto karakteristika burimi i ujit propozohet për mbrojte si Monument i Natyrës me karakter hidrologjik.

1.9. Shkalla e rrezikimit

Pavarësisht vlerave të tij natyrore, burimi është i ekspozuar ndaj ndikimeve antropogjene, si depozitimi i mbeturinave, kullotja e pakontrolluar e bagëtive dhe rreziku potencial nga aktivitetet infrastrukturore në zonën përreth. Për këtë arsye, mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tij janë të domosdoshme për ruajtjen e cilësisë së ujit dhe të ekosistemit natyror.

1.10. Historiku i mbrojtjes

Në vitit 2019 IKMN, gjatë njohjes dhe evidentimit të vlerave natyrore në Komunën e Prizrenit ka evidentuar burimin e ujit natyral në fshatin Vërmicë, si monument me vlera të rralla natyrore.

Gjatë periudhës Mars - Qershor 2023, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien nën mbrojtje të këtij monumenti të natyrës.

1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) Neni 19. paragrafi 3, Monumentet e natyrës i shpallë kuvendi i komunës në territorin e të cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje

(Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës; Nenet 19, 77, 143 paragrafi 1 dhe 2)

1. Punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës i kryen Ministria, përveç atyre punëve të cilat me këtë ligj ose ligj tjetër ju kanë besuar organit kompetent drejtues, Institutit ose komunës.
2. Komunat në pajtim me këtë ligj, strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:
   - 2.1. kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet
   - 2.2. shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.3. sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.4. marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi
   - 2.5. marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.6. kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës
   - 2.7. përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport
   - 2.8. mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës
   - 2.9. informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë
   - 2.10. ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të

pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë

2.11. kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij

1.12. Regjimi dhe masat e mbrojtjes

Burimi natyral i ujit në fshatin Vërmicë i takon kategorisë së tretë (III) sipas IUCN-së, si Monument i Natyrës. Për ruajtjen dhe përparimin e këtij monumenti të natyrës duhet respektuar këto masa mbrojtëse:

Ndalohet:

- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime te monumentit

Lejohet:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

1.13. Arsyetimi i propozimit për kategorizim

Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të Burimit te ujit natyral në fshatin Vërmicë bazohet në vlerat natyrore të këtij burimi.
Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura mund të përfundojmë se Burimit te ujit i plotëson kushtet të merret nën mbrojtje ligjore si Monument Natyror me karakter hidrologjik.

1.14. Propozimi i kategorisë

Në bazë të nenit 19. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233), **Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon që Monumenti i natyrës i karakterit hidrologjik Burimi natyral i ujit të merret nën mbrojtje në kategorinë e tretë (III) si zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.**

3. SHTOJCA



Foto 2



Foto 3

2.1. Dokumentacioni Grafik

2.1. 1. Harta e monumentit të natyrës



2.1.2. Ekstrakt nga fletë posedimi

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813008-01190-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-05/88663/
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	03.07.2023 - 15:40
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Vërmicë / Vrbnica / Vërmicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813008-01190-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privatelly owned Land		4346	1-2001		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VRBNICA-LIVALI GURES				

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Deniz.Krasnic | P-71813008-01190-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

1 / 2

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji I shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisćenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisćenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Livadhet/Livade/meadow	Livadh I Klasës 6/Livadaš Klase/6th Class Meadow	4346

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lični broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualne Državine / Single possesser	**Islamaj Shah (Xhemail)**	1007178905	/ / /		Shkozë	1/1	TRASHEGIMI LRP,NR. 9296/2021 REF.T.NR. 1146/2021 DT. 15.09.2021 NOTERI ALIRIZA BESHI RBGJ.NR 33/2021 07-463-04-142528	29.10.2021

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Deniz.Krasniq | P-71813008-01190-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

2 / 2

2.1.4. Kopje plani

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vërmicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-71813008-01190-0	Parcelë / Parcela / Parcel	4346



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 03.07.2023
Koha/ Vreme/ Time: 02:32:16
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Përfundim

Kjo arsyeshmëri profesionale e hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës paraqet vetëm një pjesë të punës profesionale të këtij instituticioni ne lëmin e mbrojtjes së natyrës. IKMN do të vazhdoje edhe me tutje të angazhohet në njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës dhe do të marrë nën mbrojtje vlerat e veçanta natyrore, në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së zonave të mbrojtura në territorin e Komunës suaj si dhe në dhënien e mendimeve profesionale në lëmin e mbrojtjes së natyrës.

IKMN–ja do të jetë gjithmonë e hapur për bashkëpunim edhe për të gjitha çështjet tjera me interes të mbrojtjes së natyrës dhe vlerave të saj.

Me kënaqësi do të pranojmë çdo sugjerim, vërejtje apo këshillë nga ana juaj lidhur me këtë elaborat duke ju sugjeruar që të merrni masa ligjore për mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore.

Ju falënderojmë sinqerisht për bashkëpunimin e ofruar gjatë realizimit të punëve në terren dhe në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Referencat:

- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233)
- Dokumentacioni nga arkivi i IKMN-se
- Plani Zhvillimir Komunal për Prizrenin, komuna e Prizrenit
- Dokumentacioni nga Shërbimi Kadastral i KK Prizrenit
- Harta topografike e Kosovës 1 : 25000
- Atlas i Bimëve të Kosovës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Rr. Luan Haradinaj, ish Rilindja, kati XIV nr. 1403/A
10 000 Prishtine, KOSOVË
Tel. 038 200 33 236
http://ammk-rks.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVËS	KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE	KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

ELABORAT:

STUDIMI PËR ARSYESHMËRINË PROFESIONALE PËR MARRJEN NËN MBROJTJE TË VLERËS SË NATYRËS: BURIMI I UJIT NATYRAL NË FSHATIN POSLISHTË TË PRIZRENIT SI MONUMENT I NATYRËS

Prishtinë,
Qershor 2023

Në përgatitjen e këtij elaborati morrën pjesë:

Udhëheqës i punëve:

Dr. sc. Sami Behrami – Udhëheqës i sektorit të zonave të mbrojtura

Hulumtimi në terren:

Dr. sc. Sami Behrami – Udhëheqës i sektorit të zonave të mbrojtura

Bsc. Shkurte Selimi – Praktikante IKMN

Bsc. Vjollca Hajredini – Praktikante IKMN

Bashkëpunëtor të jashtëm:

Muhamet Bajrami– Udhëhqës i sektorit për mjedis dhe menaxhim të mbeturinave

Galip Belallari– Bashkëpuntor profesional në sektorin e mjedisit dhe mbeturinave

Parathënie

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është trashëgimtar i Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i themeluar me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, (GZ. 42/74) dhe ka vazhduar punën me të njëjtin emër sipas ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (GZ. 15/81).

Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë ligjin për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK"39/88) ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89).

Pas luftës në Kosovë, në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme civile të OKB-se me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës".

Nga maji i vitit 2000, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka vepruar ne kuadër të Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsa pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës, vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

Aktualisht IKMN, vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit e cila është themeluar duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. (Rreg. 2003/9).

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës[1] në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre

[1] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233

- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve
- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës
- pjesëmarrje në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës

Gjatë pranverës së vitit 2019, IKMN në kuadër të aktiviteteve të tij ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Prizrenit. Në vitin 2019, IKMN i ka propozuar Kuvendit Komunal të Prizrenit iniciativën për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje.

Gjatë periudhës Mars - Qershor 2023, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien në mbrojte të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Prizrenit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si organ qendror për mbrojtjen e natyrës, ka përgatitur Elaboratin: **Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës Burimi i ujit natyral në fshatin Poslishtë të Prizrenit si Monument i Natyrës.**

Përmbajtja

1. Baza profesionale dhe dokumentimi për marrjen në mbrojtje të vlerës natyrore
    - 1.1. Emërtimi i vlerës natyrore
    - 1.2. Lloji i monumentit
    - 1.3. Kategoria e mbrojtjes
    - 1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së
    - 1.5. Pozita
    - 1.6. Kufijtë
    - 1.7. Sipërfaqja
    - 1.8. Përshkrimi i vlerës natyrore
        - 1.8.1. Karakteristikat natyrore
        - 1.8.2. Karakteristikat tjera
        - 1.8.3. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore
    - 1.9. Shkalla e rrezikimit
    - 1.10. Historiku i Mbrojtjes
    - 1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim
    - 1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje
    - 1.13. Regjimi dhe masat mbrojtëse
    - 1.14. Arsyetimi i Propozimit për Kategorizim
    - 1.15. Propozimi i Kategorisë
2. Shtojcat
    - 2.1. Dokumentacioni grafik
        - 2.1.1. Harta e vlerës natyrore
        - 2.1.2. Ekstrakti nga fleteposedimi
        - 2.1.3. Kopja e Planit
    - 2.2. Dokumentacioni Fotografik

Referencat

1. BAZA PROFESIONALE DHE DOKUMENTIMI PËR MARRJEN NË MBROJTJE LIGJORE TË VLERËS NATYRORE



Foto 1

1.1. Emërtimi i vlerës natyrore

Burimi i ujit natyral në fshatin Poslishtë të Prizrenit.

1.2. Lloji i monumentit

Monument natyror me karakter hidrologjik.

1.3. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

1. Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.
2. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233) Neni 14.

1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së

Kategoria e tretë (III).
Monument natyror (Natural Monument/Natural Landmark)
("Korniza për klasifikimin e zonave te mbrojtura tokësore dhe detare, IUCN, 1990)

1.5. Pozita

Monumenti natyror Burimi i ujit natyral gjendet në fshatin Poslishtë në pronësi shoqërore, Komunës së Prizrenit dhe është në gjendje relativisht e mirë edhe pse kohëve të fundit janë konstatuar nderhyrje deri në afërsi të burimit.

Sipas matjeve me GPS burimi ndodhet në koordinatat:
X = 0472657
Y = 4669598
Lartësia mbidetare = 346 l.m.d

1.6. Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Burimi i ujit natyral në fshatin Poslishtë, zona kadastrale Poslishte, nr. P-71813067-00732-0, me sipërfaqe 57185 m^2, e regjistruar si pronë shoqërore (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, K. K. Prizren).

Si kufi për Monumentin e Natyrës – Burimi i ujit natyral të merret kufiri i parcelës kadastrale me siperfaqe të pergjishem.

1.7. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit natyror përfshinë hapësirën të cilën e mbulojnë dhe hapësirën përreth, si para zonë mbrojtëse (Zonë buferike).
Propozohet për mbrojtje sipërfaqja prej S = 50 ari

1.8 Përshkrimi i vlerave

1.8.1 Karakteristikat natyrore

Monumenti natyror Burimi i ujit natyral gjendet në fshatin Poslishtë. Burimi karstik i ujit natyral karakterizohet me prurje të konsiderueshme të ujit. Burimi është natyral pa erë dhe përbërje natyrale.
Karakterizohet me pamje impozante dhe gjëndje të mirë natyrore. Në gjëndje të mirë ndodhet edhe parku te burimi i cili ofron kushte për pushim për banorët vendas dhe banorët tjerë.

Burimi përfaqëson një shkarkim tipik karstik (limnokren), ku uji nëntokësor del nën presion në sipërfaqe duke formuar një pellg ose pishinë natyrore ujore statike përpara se të fillojë rrjedhën sipërfaqësore. Shtrati komunikon direkt me një formacion shkëmbor tektonik të thyer (gëlqerorë të makro-frakturuar). Bazamenti (shtrati) i pellgut përbëhet nga sedimente klastike aluviale (zhavorr dhe gurë të lëmuar) dhe depozitime karbonatike. Temperatura konstante të ulët krijon një mikroklimë të freskët dhe me lagështi të lartë relative (higrofite) në zonën rrethuese. Shpatet shkëmbore dhe dherat anësore mbulohen nga një vegjetacion ku dominojnë shkurret mbrojtëse, briofitet (myshqet e lagështisë) dhe bimësia drunore.

1.8.2. Karakteristikat tjera

Përveç vlerave natyrore burimi i ujit mineral ka edhe vlera tjera të rëndësishme si vlera hidrologjike, gjeomorfologjike, turistike etj.

1.8.3. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore

Monumenti natyror Burimi i ujit natyral në fshatin Poslishtë. Burimi karstik i ujit natyral karakterizohet me prurje të konsiderueshme të ujit. Burimi është natyral pa erë dhe përbërje natyrale.

Duke marrë për bazë këto karakteristika burimi i ujit mineral propozohet për mbrojte si Monument i Natyrës me karakter hidrologjik.

1.9. Shkalla e rrezikimit

Ekosistemi i "Gurrës së Poslishtit" ekspozohet ndaj ndikimit të vazhdueshëm njerëzor, ku si rreziqe potenciale identifikohen: fluksi i vizitorëve për shëtitje dhe rekreacion, ndotja nga mbetjet e ngurta, si dhe prania e infrastrukturës komerciale (restorantet dhe kafenetë) që shton rrezikun e infiltrimit të ujërave të ndotura direkt në burim.

1.10. Historiku i mbrojtjes

Në vitit 2019 IKMN, gjatë njohjes dhe evidentimit të vlerave natyrore në Komunën e Prizrenit ka evidentuar burimin e ujit natyral në fshatin Poslishtë, si monument me vlera të rralla natyrore.
Në vitin 2019 IKMN i ka propozuar Kuvendit Komunal të Prizrenit marrjen në mbrojte të këtij burimi (Iniciativë për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje).
Gjatë periudhës Mars - Qershor 2023, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien nën mbrojtje të këtij monumenti të natyrës.

1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) Neni 19. paragrafi 3, Monumentet e natyrës i shpallë kuvendi i komunës në territorin e të cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje

(Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës; Nenet 19, 77, 143 paragrafi 1 dhe 2)

1. Punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës i kryen Ministria, përveç atyre punëve të cilat me këtë ligj ose ligj tjetër ju kanë besuar organit kompetent drejtues, Institutit ose komunës.
2. Komunat në pajtim me këtë ligj, strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:
   - 2.1. kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet
   - 2.2. shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.3. sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.4. marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi
   - 2.5. marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   - 2.6. kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin

mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës

2.7. përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport

2.8. mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës

2.9. informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë

2.10. ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë

2.11. kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij

1.12. Regjimi dhe masat e mbrojtjes

Burimi i ujit natyral në fshatin Poslishtë i takon kategorisë së tretë (III) sipas IUCN-së, si Monument i Natyrës. Për ruajtjen dhe përparimin e këtij monumenti të natyrës duhet respektuar këto masa mbrojtëse:

Ndalohet:

- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
- Ndërhyrjet në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime te monumentit

Lejohet:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

1.13. Arsyetimi i propozimit për kategorizim

Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të Burimit te ujit natyral në fshatin Poslisht bazohet në vlerat natyrore të këtij burimi.
Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura mund të përfundojmë se Burimit te ujit i plotëson kushtet të merret nën mbrojtje ligjore si Monument Natyror me karakter hidrologjik.

1.14. Propozimi i kategorisë

Në bazë të nenit 19. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233), **Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon që Monumenti i natyrës i karakterit hidrologjik Burimi i ujit natyral të merret nën mbrojtje në kategorinë e tretë (III) si zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.**

SHTOJCA



Foto 2



Foto 3



Foto 4

2.1. Dokumentacioni Grafik

2.1. 1. Harta e monumentit të natyrës



2.1.2. Ekstrakt nga fletë posedimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813067-00732-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-05/88663/
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	05.07.2023 - 15:40
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Poslishtë / Poslište / Poslishtë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813067-00732-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		57185			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RUDINA-RUDINA				

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Deniz.Krasnic | P-71813067-00732-0 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person | 1 / 2

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agricultare	Kullosat/Pašnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture	57185

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualno Drzavina / Single possessor	**P.SH. PYLLTARIA PRIZREN**	KCID1815524	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN /		BAJRAM CURRI	1/1		

2.1.4. Kopje plani

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Poslishtë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-71813067-00732-0	Parcelë / Parcela / Parcel	57185



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3605

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 03.07.2023
Koha/ Vreme/ Time: 02:37:07
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: p.s. Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Përfundim

Kjo arsyeshmëri profesionale e hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës paraqet vetëm një pjesë të punës profesionale të këtij instituticioni ne lëmin e mbrojtjes së natyrës. IKMN do të vazhdoje edhe me tutje të angazhohet në njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës dhe do të marrë nën mbrojtje vlerat e veçanta natyrore, në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së zonave të mbrojtura në territorin e Komunës suaj si dhe në dhënien e mendimeve profesionale në lëmin e mbrojtjes së natyrës.

IKMN–ja do të jetë gjithmonë e hapur për bashkëpunim edhe për të gjitha çështjet tjera me interes të mbrojtjes së natyrës dhe vlerave të saj.

Me kënaqësi do të pranojmë çdo sugjerim, vërejtje apo këshillë nga ana juaj lidhur me këtë elaborat duke ju sugjeruar që të merrni masa ligjore për mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore.

Ju falënderojmë sinqerisht për bashkëpunimin e ofruar gjatë realizimit të punëve në terren dhe në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Referencat:

- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233)
- Dokumentacioni nga arkivi i IKMN-se
- Dokumentacioni nga Shërbimi Kadastral i KK Prizrenit
- Harta topografike e Kosovës 1 : 25000

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Rr. Luan Haradinaj, ish Rilindja, kati XIV nr. 1403/A
10 000 Prishtine, KOSOVË
Tel. 038 200 33 236
http://ammk-rks.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

ELABORAT:

STUDIMI PËR ARSYESHMËRINË PROFESIONALE PËR MARRJEN NËN MBROJTJE TË VLERËS SË NATYRËS: KOMPLEKSI I PISHAVE (*Pinus nigra*) NË FSHATIN MALËSI E RE TË PRIZRENIT SI PEIZAZH I MBROJTUR

Prishtinë,
Qershor 2023

Në përgatitjen e këtij elaborati morrën pjesë:

Udhëheqës i punëve:

Dr. sc. Sami Behrami – Udhëheqës i sektorit të zonave të mbrojtura

Hulumtimi në terren:

Dr. sc. Sami Behrami – Udhëheqës i sektorit të zonave të mbrojtura

Bsc. Shkurte Selimi – Praktikante IKMN

Bsc. Vjollca Hajredini – Praktikante IKMN

Bashkëpunëtor të jashtëm:

Muhamet Bajrami– Udhëheqës i sektorit për mjedis dhe menaxhim të mbeturinave

Galip Belallari– Bashkëpuntor profesional në sektorin e mjedisit dhe mbeturinave

Parathënie

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është trashëgimtar i Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i themeluar me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, (GZ. 42/74) dhe ka vazhduar punën me të njëjtin emër sipas ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (GZ. 15/81).

Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë ligjin për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK"39/88) ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89).

Pas luftës në Kosovë, në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme civile të OKB-se me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës".

Nga maji i vitit 2000, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka vepruar ne kuadër të Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsa pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës, vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

Aktualisht IKMN, vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit e cila është themeluar duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. (Rreg. 2003/9).

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës[1] në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre

[1] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233

- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve
- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës
- pjesëmarrje në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës

Gjatë pranverës së vitit 2019, IKMN në kuadër të aktiviteteve të tij ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Prizrenit. Në vitin 2019, IKMN i ka propozuar Kuvendit Komunal të Prizrenit iniciativën për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje.

Gjatë periudhës Mars - Qershor 2023, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien në mbrojte të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Prizrenit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si organ qendror për mbrojtjen e natyrës, ka përgatitur Elaboratin: **Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës Kompleksi i Pishave në fshatin Malësi e re të Prizrenit si Peizazh i Mbrojtur.**

Përmbajtja

1. Baza profesionale dhe dokumentimi për marrjen në mbrojtje të vlerës natyrore
    - 1.1. Emërtimi i vlerës natyrore
    - 1.2. Lloji i monumentit
    - 1.3. Kategoria e mbrojtjes
    - 1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së
    - 1.5. Pozita
    - 1.6. Kufijtë
    - 1.7. Sipërfaqja
    - 1.8. Përshkrimi i vlerës natyrore
        - 1.8.1. Karakteristikat natyrore
        - 1.8.2. Karakteristikat tjera
        - 1.8.3. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore
    - 1.9. Shkalla e rrezikimit
    - 1.10. Historiku i Mbrojtjes
    - 1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim
    - 1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje
    - 1.13. Regjimi dhe masat mbrojtëse
    - 1.14. Arsyetimi i Propozimit për Kategorizim
    - 1.15. Propozimi i Kategorisë
2. Shtojcat
    - 2.1. Dokumentacioni grafik
        - 2.1.1. Harta e vlerës natyrore
        - 2.1.2. Ekstrakti nga fleteposedimi
        - 2.1.3. Kopja e Planit
    - 2.2. Dokumentacioni Fotografik

Referencat

1. BAZA PROFESIONALE DHE DOKUMENTIMI PËR MARRJEN NË MBROJTJE LIGJORE TË VLERËS NATYRORE



Foto 1

1.1. Emërtimi i vlerës natyrore

Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi e re të Prizrenit.

1.2. Lloji i monumentit

Peizazh i mbrojtur me karakter botanik.

1.3. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e pestë e mbrojtjes (V) – Peizazh i mbrojtur

Peizazhi i mbrojtur

1. Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion.

2. Në peizazhin e mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallë i mbrojtur.

(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233) Neni 15.

1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së

Kategoria e pestë (V).
Peizazh i mbrojtur (Protected landscape)
("Korniza për klasifikimin e zonave te mbrojtura tokësore dhe detare, IUCN, 1990)

1.5. Pozita

Peizazhi i mbrojtur Kompleksi i pishave përbëhet nga 15 ha te kultivuar me *(Pinus nigra)* dhe gjendet në fshatin Malesi e re, në pronësi shoqërore, Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe janë në gjendje të mirë.

Sipas matjeve me GPS trungjet ndodhen në koordinatat:
X = 0483853
Y = 4680265
Lartësia mbidetare = 467 l.m.d

1.6. Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi të re të komunës së Prizrenit, zona kadastrale Korishe, nr. P-71813037-000800-1, me sipërfaqe 424134m^2, e regjistruar si pronësi te D.S.RAD.ORG.SHUMAR. SHARRI PRISHTINA OS.ORG.UDR.RADA SHUMSKO GAZDINISTVO- Kuvendit të Komunës së Prizrenit (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, K. K. Prizrenit).

Si kufi për Peizazhit të mbrojtur – Kompleksi i pishës *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi e re të merret siperfaqja e një pjese të parceles kadastrale.

1.7. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Peizazhit të mbrojtur përfshinë hapësirën të cilën e mbulojnë Pisha dhe Dëllinja, si dhe hapësirën përreth.
Propozohet për mbrojtje sipërfaqja prej 15 ha.

1.8 Përshkrimi i vlerave

1.8.1 Karakteristikat natyrore

Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* gjendet në fshatin Malësi e re. Pishat e këtij kompleksi janë të kultivuara në vitet e 80-ta, me sipërfaqe 15 ha. Karakterizohen me pamje dhe gjendje të mirë dhe i takojnë llojit Pishë e Zezë *(Pinus nigra)* dhe Dëllinja *(Juniperus communis).*

Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* i kanë këto karakteristika dendrometrike:

Lartësia e kërcellit ..... nga 15 m
Perimetri i trungut ..... nga 2.0 deri 5.5 m
Diametri i kurorës..... nga 12 deri 25 m
Vjetërsia e trungut ..... nga 45 deri 55 vite

Gjendja natyrore e trungjeve është relativisht e mirë.

1.8.2. Karakteristikat tjera

Përveç vlerave natyrore pishat dhe dëllinjat kanë edhe vlera tjera të rëndësishme si vlera estetike, dekorative dhe turistike.
Madhësia, pamja estetike dhe dekorative e bënë këto pisha objekte shumë atraktive për vizitoret.

1.8.3. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore

Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi e re janë pisha me vlera të rralla të këtij llojit që mund të gjendet në këtë rajon. Vjetërsia, vitaliteti dhe përmasat e kërcellit dhe kurorës i bëjnë këtë kompleks me pisha një monument me vlera të rralla natyrore, shkencore dhe turistike.
Duke marrë për bazë këto karakteristika këto trungje propozohet për mbrojte si Peizazhit të mbrojtur me karakter botanik.

1.9. Shkalla e rrezikimit

Në afërsi të kompleksit nuk ka ndonjë burim të ndotjes që do të mund ta rrezikonte në mënyrë të drejtpërdrejte atë. Gjendja aktuale natyrore e trungjeve është e mirë, ndërsa në pjesën e kurorës së trungut nuk vërehet ndonjë degë e tharë.

1.10. Historiku i mbrojtjes

Në vitit 2019 IKMN, gjatë njohjes dhe evidentimit të vlerave natyrore në Komunën e Prizrenit ka evidentuar Kompleksin e pishave (*Pinus nigra*) dhe dëllinjave (Juniperus communis) në fshatin Malësi e Re si monument me vlera të rralla natyrore.
Gjatë periudhës Mars - Qershor 2023, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien nën mbrojtje të këtij Peizazhit të mbrojtur.

1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) Neni 19. paragrafi 3, Peizazhet e mbrojtura i shpallë kuvendi i komunës në territorin e të cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje

(Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës; Nenet 19, 77, 143 paragrafi 1 dhe 2)

1. Punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës i kryen Ministria, përveç atyre punëve të cilat me këtë ligj ose ligj tjetër ju kanë besuar organit kompetent drejtues, Institutit ose komunës.
2. Komunat në pajtim me këtë ligj, strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:
   2.1. kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet
   2.2. shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   2.3. sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura

për të cilat janë kompetente

2.4. marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi

2.5. marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente

2.6. kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës

2.7. përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport

2.8. mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës

2.9. informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë

2.10. ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë

2.11. kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij

1.12. Regjimi dhe masat e mbrojtjes

Kompleksi i pishave (*Pinus nigra*) dhe dëllinjave (*Juniperus communis*) në fshatin Malësi e Rei takon kategorisë së pestë (V) sipas IUCN-së, si Peizazh i mbrojtur. Për ruajtjen dhe përparimin e këtij peizazhi natyror duhet respektuar këto masa mbrojtëse:

Ndalohet:

- Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo frutave, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme natyrore
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur
- Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime te monumentit

Lejohet:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Pizazhit të mbrojtur nën kushtet të cilat i përcakton Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Pizazhit të mbrojtur si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Pizazhit të mbrojtur.

1.13. Arsyetimi i propozimit për kategorizim

Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të Kompleksit të pishave (*Pinus nigra*) fshatin Malësi e Re bazohet në vlerat natyrore të trungjeve. Trungjet karakterizohen për nga pamja estetike, trashësia, vjetërsia, vitaliteti dhe pozita shumë e mirë.
Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura mund të përfundojmë se Kompleksi i pishave *(Pinus nigra*) i plotëson kushtet të merret nën mbrojtje ligjore si Peizazh i mbrojtur me karakter botanik.

1.14. Propozimi i kategorisë

Në bazë të nenit 19. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233**), Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon që Pizazhi i mbrojtur i karakterit botanik Kompleksi i pishave (*Pinus nigra*) të merret nën mbrojtje në kategorinë e pestë (V) si zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.**

SHTOJCA



Foto 1



Foto 2



Foto 3



Lënda e Pishës së zezë (Pinus nigra)

2.1. Dokumentacioni Grafik

2.1. 1. Harta e monumentit të natyrës



2.1.2. Ekstrakt nga fletë posedimi

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813037-00800-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-05/88663/
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	03.07.2023 - 15:41
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Korishë / Koriša / Korishë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813037-00800-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	424134			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BOKA-BOKA				

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Deriz.Krasnic | P-71813037-00800-1 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

1 / 2

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

